

Udhëzues i gazetarëve për marrëdhënie me policinë

Si policia ashtu edhe mediat i kanë objektivat dhe funksionet legjitime profesionale, të cilat duhet të respektohen, të kuptohen drejt dhe të vlerësohen nga të dyja palët me qëllim që ndërmjet tyre të krijohen raporte të suksesshme të punës, që janë me interes të përbashkët.

1. Gazetarët duhet të jenë të gatshëm të identifikohen në kontaktet e tyre zyrtare me policinë. Zakonisht mjafton kartela identifikuese e gazetarit në të cilën janë të përfshira emri dhe fotografia e gazetarit si dhe emri, adresa, logjoja dhe vula e medias.
2. Gazetarët duhet t'i ndjekin dhe respektojnë procedurat e përcaktuara nga policia nëse dhe kur hyjnë në zonat e ndaluara me ligj.
3. Nga gazetarët mund të kërkohet të marrin leje nga policia ose autoritetet e tjera për qasje në vendet e veçanta (fjala vjen në vendet e krimit ose në repartet e sigurisë), dhe mund t'i nënshtrohen kufizimeve specifike sa i takon mënyrës së sjelljes në këto vende (p.sh. pa fotografime). Brenda mundësive, kushtet e qasjes duhet të përcaktohen paraprakisht.
4. Gazetarët duhet t'i përmbahen kodeve të mirësjelljes që janë në fuqi në Kosovë.
5. Gazetarët duhet t'i kushtojnë kujdes maksimal raportimit të saktë dhe t'i shmangen publikimit të qëllim të materialeve të pasakta, çorientuese apo të shtrembëruar. Njëherazi, gazetarët duhet t'i shmangen publikimit të qëllim të apo me dashje të informatës, që mund t'i rrezikojë veprimet dhe/ose hetimet e policisë.
6. Gazetarët e kanë për obligim që t'i mbrojnë burimet e besueshme të informatave nëse merren në pyetje nga policia. Gazetarët, sikurse edhe qytetarët e tjerë, kanë të drejtë të angazhojnë avokat nëse merren në pyetje nga policia.
7. Gazetarët kanë përgjegjësi të veçanta sa i takon zbulimit të identitetit të viktimave të krimit. Kështu, identiteti i fëmijëve nën moshën 18 vjeçare, pa marrë parasysh a janë viktimë apo autorë të dyshuar të krimit, duhet të mbrohet derisa policia nuk i bën të ditur emrat. Viktimat e krimeve të urrejtjes dhe në veçanti viktimat e dhunës familjare nuk duhet të identifikohen pa lejen e viktimës. Identiteti i viktimave, që kanë vdekur si pasojë e krimit, duhet të zbulohet vetëm pasi të jetë njoftuar familja e afërt dhe pasi të jetë kryer identifikimi zyrtar.
8. Gazetarët të cilëve u urdhërohet ta dorëzojnë materialin e siguruar përmes aktiviteteve legale gazetareske kanë të drejtë, që me këtë rast, të kërkojnë dhe autorizim të dokumentuar nga policia. Nëse urdhëresa ose mandati gjyqësor e autorizon, atëherë policia mund ta konfiskojë përkohësisht materialin, i cili mund të shërbejë si dëshmi gjatë procedurave penale. Këto materiale duhet t'i kthehen për ruajtje gjykatës apo të ruhen në mënyra të tjera sipas përcaktimit të gjykatës. Sidoqoftë, materiali i tillë nuk duhet të përdoret për qëllime të raportimit përderisa të merret mendimi ligjor për te.



Udhëzues i policisë për marrëdhënie me media

Si policia ashtu edhe mediat i kanë objektivat dhe funksionet legjitime profesionale, të cilat duhet të respektohen, të kuptohen drejt dhe të vlerësohen nga të dyja palët me qëllim që ndërmjet tyre të krijohen raporte të suksesshme të punës, që janë me interes përbashkët.

1. Policia duhet të ketë aso marrëdhënie me gazetarë, që bazohen në respektimin e të drejtave të tyre, përfshirë këtu:
Të drejtën e lirisë së shprehjes dhe drejtën e lirisë së lëvizjes, duke e përfshirë të drejtën për të udhëtuar të papenguar gjatë përbushjes së detyrave profesionale. Gazetarët nuk mund të arrestohen apo të ndalohen pa ndonjë arsye, të bazuar në ligj.
2. Policia nuk mund të kërkojë nga gazetarët që të paraqiten në polici gjatë kryerjes së punëve të tyre, përveç në rastet kur nevojitet qasje e veçantë (p.sh. në vendin e krimit). Gazetarët nuk duhet të hyjnë në zona të ndaluara me ligj, që janë qartë të kufizuara ose të shënuara nga autoritetet përkatëse.
3. Policia nuk mund të ndërhyjë apo t'i ndëshkojë gazetarët nëse ata i zhvillojnë aktivitetet e tyre profesionale në mënyrë legale nëse ato aktivitetet zhvillohen në përputhshmëri me ligjet e aplikueshme në Kosovë.
4. Policia nuk mund t'i konfiskojë pajisjet ose materialet profesionale nga gazetarët, përpos nëse një gjë e tillë autorizohet me urdhëresë apo justifikim nga gjyqi. Materialet të cilat konfiskohen në bazë të kodit penal ose të cilat mund të shërbejnë si dëshmi në procedurat penale mund të konfiskohen përkohësisht dhe pastaj t'i kthehen gjykatës për t'i ruajtur.
5. Policia mund ta kërkojë identifikimin e gazetarëve vetëm atëherë kur gazetarët kërkojnë të kenë qasje në vendet ose ngjarjet, që janë të hapura për gazetarët, por të mbyllura për publikun e gjerë. Identifikimi profesional përfshirë këtu emrin dhe fotografinë e gazetarit, dhe emrin, adresën, logon dhe vulën zyrtare të lëshuar nga media mjaftojnë për t'i vërtetuar letrat kredenciale.
6. Pjesëtarët e policisë duhet të jenë të gatshëm që të identifikohen për çdo qytetar që e kërkon një gjë të tillë. Të gjithë pjesëtarët e policisë vendore si dhe personat përkohësisht të autorizuar që t'i ushtrojnë funksionet e policisë duhet t'i mbajnë me vete dokumentet e identifikimit të lëshuara nga agjencia e tyre policore.
7. Policia nuk mund t'i detyrojë gazetarët që t'i zbulojnë burimet e tyre të besueshme të informatave.
8. Policia duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë hetimit të të gjitha akteve, ekzistuese ose parajlmëruese, të dhunës, kërcënimit ose shqetësimit të drejtuar si kundër personelit të mediave ashtu edhe ndaj shkatërrimit të pronës së mediave.